



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 479/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-70791-09-04-2020, me objekt: “Evadim mbetje spitalore per nevoja te DSR Diber per vitin 2020”, me fond limit 1.999.998 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2020, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.

Ankimues: “Medi Tel” shpk
Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, Km.1, Rruga “Vidhe Gjata” Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.
Adresa: Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1, të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.09.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-70791-09-04-2020, me objekt: “*Evadim mbetje spitalore per nevoja te DSR Diber per vitin 2020*”, me fond limit 1.999.998 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2020, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal, Dibër.

II.2. Në datën 14.09.2020 operatori ekonomik “*Medi Tel*” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër ka publikuar në adresën e www.app.gov.al procedurën e prokurimit KËRKESE PËR PROPOZIM SHËRBIME me objekti i kontratës: “Evadim i mbetjeve spitalore për nevoja të DSR Dibër për vitin 2020”, Numri i referencës së procedurës: REF-70791-09-04-2020, fondi limit: 1,999,998 (Një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh dhe afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 18/09/2020, Ora: 10:00.

2.2 Operatori ekonomik “Medi-Tel” shpk do të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi publikuar në adresën e www.app.gov.al, procedurën e prokurimit KËRKESE PËR PROPOZIM SHËRBIME me objekti i kontratës: Evadim i mbetjeve spitalore për nevoja të DSR Dibër për vitin 2020”, Numri i referencës së procedurës: REF-70791-09-04-2020, fondi limit: 1,999,998 (Një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh, por nga shqyrtimi kriterëve të pjesëmarrjes në DST disa prej këtyre kriterëve janë të paligjshëm e në shpërpjestim me objektin e tenderit.

Konkretisht:

PIKA 1

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

A. Operatori ekonomik duhet të disponoje Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjesimit të jetë me incenerim.

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me vetë përcaktimet e dhëna në specifikimet teknike të vendosura nga AK në DST. Vetë AK në specifikimet teknike dhe në titullin e tenderit nuk përmend në asnjë pjesë se do të evadohen edhe kimikate, por gjatë gjithë përmbajtjes së kësaj procedure AK i referohet gjithmonë mbetjeve spitalore. Duke qënë se këto lloj mbetjesh që i përkasin kodeve 18 01 06 dhe 18 01 07 janë kimikate si të tilla nuk duhen tenderuar në të njëjtën procedurë me atë të mbetjeve spitalore. Për këtë arsye kërkojmë që këto dy kode të hiqen nga ky kriter.

Përsa i përket kodit 18 01 08 (Medikamente citostatika dhe citotoksike) nga informacionet e marra në dijeninë tonë Spitali Rajonal Dibër nuk i prodhon këto lloj mbetjesh dhe si i tillë këto lloj mbetjesh nuk duhet të kërkojnë në këtë procedurë tenderimi. Por edhe nëse nga ana e Spitalit Rajonal Dibër pretendohet se gjenerohen këto lloj mbetjesh (citostatika dhe citotoksina) sasia që prodhohet nga Spitali Rajonal Dibër është shumë e vogël në krahasim me llojet e tjera të mbetjeve (18 01 01, 18 01 02 dhe 18 01 03) marrë shkas këtu edhe nga procedura e tenderimit nga Spitalet e tjerë Rajonal që operojnë në Republikën e Shqipërisë gjenerohen shumë më pak mbetje të këtij lloji, shoqëria jonë nuk e ka parë të arsyeshme pajisjen me leje përkatëse me kodin 18 01 08, por ka bërë një aktmarrveshje bashkëpunimi me një shoqëri të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve. Prandaj kërkojmë që ky kod (18 01 08) të hiqet ose në rast se Spitali Rajonal Dibër është prodhues i këtyre mbetjeve, ta modifikojë atë duke kërkuar Leje Mjedisore ose Licensë ku të ketë kodin 18 01 08 ose një aktmarrveshje me një operator të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve.

Ky kriter shkel:

nenin 46.1 të LPP që përcakton “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional; b) aftësia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare; q) kapacitetet ligjore.”.

Nenin 23.1 të LPP “Specifikimet teknike që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, pinëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

PIKA 2

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 24 muaj pas hapjes së ofertave (sa kohëzgjatja e marrveshjes kuadër).

Një kriter i tillë është në thelb diskriminues duke përjashtuar tërthorazi një operator ekonomik, në rastin konkret, duke kërkuar në mënyrë taksative afatin prej minimalisht 24 muajsh, në këtë mënyrë duke kategorizuar dhe përjashtuar çdo operator ekonomik që disponon një kontratë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertës dhe me të drejtë rinovimi, të lidhur me një landfill të licencuar. Ju kujtojmë se përkatësisht ne si operator ekonomik, në kontratën e lidhjes me landfillin “Integrated Energy BV SPV”, afati i saj është 1 vjeçar me të drejtë rinovimi. Ju bëjmë me dije se ky landfill nuk ofron kontrata me afat më shumë se 1 vit (12 muaj). Dhe duke qënë se ne si shoqëri ndodhemi në qarkun e Tiranës dhe Landfilli Integrated Energy BV SPV është landfilli i vetëm i licencuar në këtë qark jemi të detyruar të lidhim kontratë me këtë landfill. Një përcaktim prej një periudhe 24 mujore si një kriter kualifikimi bëhet pengesë duke penalizuar operatorin ekonomik mbështetur në një rrethanë që rëndësineë e vet duhet të përqëndrojë te fakti se operatori ekonomik duhet të zotërojë një kontratë e cila në momentin e hapjes së ofertës të jetë aktive.

Për rrjedhojë ju drejtohem me këtë ankesë duke kërkuar nga ju ndërmarrjen e masave për modifikimin e një kriteri përjashtues dhe diskriminues që në mënyrë decizive dhe jo të drejtë përjashton bazuar në këto cilësime. Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi , të LPP dhe të të drejtave që i njeh operatorit ekonomik: kërkojmë modifikimin e këtij kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licencuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave.

PIKA3

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.4.10 Operatori ekonomik ofertues do të sjellë në ambjentet e autoritetit kontraktor në datën dhe orën e hapjes së tenderit nga një mostër të kontenitorëve si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje 60 kontenitorë (30 copë 3-7 L dhe 30 copë 30-70L) për mbulimin e nevojave AK

- Kontenierët e vegjël për mbetjet e mprehta, kontenitor plastik, minimalisht 2 përmasa me kapacitet nga 3 L deri në 7 litra, nga 1 mostër për secilën përmasë;

- Kontenierët e mëdhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhë me 1 përdorim, minimalisht 4 përmasa me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra (nga këto, të paktën njëra nga përmasat e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara)

– nga 1 mostër për secilën përmasë.

Mostrat e dorëzuara, duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse mostra/t nuk është/janë në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e: “të paktën njëra nga përmasat e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara”, një kriter i tillë është në thelb diskriminues duke përjashtuar tërthorazi një operator ekonomik, në rastin konkret, duke kërkuar në mënyrë taksative që OE të paraqesë një mbajtëse metalike (karele), i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, pasi OE mund të disponojë/punoë (me) një formë karele të ndryshme nga kjo e kërkuar në DST. Duhet theksuar se karela në vetvete bën transportimin e kontenitorëve. Për më tepër mbajtësja metalike (karela) të cilës AK i referohet nuk bën mbyllje të sigurt të kapakut të kontenitorëve të mbetjeve (referuar të gjitha karelave të cilat bëjnë hapjen e kapakut me anë të pedanit), duke humbur kështu në tërësi evitimin e kontaktit të personelit me mbetjet e infektuara. AK është e vetëdijshme se kontenitorët janë të pajisura me qese, të cilat janë në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi, dhe duke marrë të mirëqënë faktin se punonjësit e DRS Diber respektojnë me rigorozitet të gjitha masat parandaluese (maskë, doreza, dezinfektant, etj), si e tillë mundësia e kontaktit me pjesë të infektuara është e papërfillshme.

Ky kriter shkel:

nenin 46.1 të LPP që përcakton “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional; b) aftësia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare; q) kapacitetet ligjore.”.

Nenin 23.1 të LPP “Specifikimet teknike që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, pinëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshem e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Nisur nga kjo kërkojmë modifikimin e këtij kriteri si më poshtë:

2.4.10 Operatori ekonomik ofertues do të sjellë në ambjentet e autoritetit kontraktor në datën dhe orën e hapjes së tenderit nga një mostër të kontenitorëve si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje 60 kontenitorë (30 copë 3-7 L dhe 30 copë 30-70L) për mbulimin e nevojave AK

- Kontenierët e vegjël për mbetjet e mprehta, kontenitor plastik, minimalisht 2 përmasa me kapacitet nga 3 L deri në 7 litra, nga 1 mostër për secilën përmasë;

- Kontenierët e mëdhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhë me 1 përdorim, minimalisht 4 përmasa me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra – nga 1 mostër për secilën përmasë.

- Mbajtëse metalike/karelë me rrota.

Mostrat e dorëzuara, duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse mostra/t nuk është/janë në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Duke u bazuar në sa më sipër:

Lutemi që ankesa jonë të merret parasysh.

II.3. Në datën 17.09.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar pjesërisht ankesën me argumentat si më poshtë vijon:

Në përgjigje të ankesës së depozituar në Drejtorinë e Spitalit Rajonal Dibër, nga operatori ekonomik “Medi Tel” shpk, me nr. 788 prot, datë 14.09.2020, për dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit me objekt: “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore – Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit i marrëveshjes kuadër 1.999.998 lekë pa-TVSH, sqarojmë si vijon:

Përsa i përket Pikës nr.1

Në lidhje me pikën 2.1.A të DST,

A. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjесimit të jetë me incenerim.

Përsa i përket pretendimeve të OE Medi-Tel për kodet 18 01 06 dhe 18 01 07 se janë kimikate dhe si të tilla duhet të hiqen nga kriteret, sqarojmë se të gjitha barnat janë të përbëra nga lëndë kimike gjatë prodhimit të tyre, dhe rmbetjet që do trajtohen janë kryesisht amballazhet e barnave, dhe materiale mjekimi të cilat janë përdorur për të injektuar barna ose për të mjekuar pacientët me anë të barnave dhe detyrimisht amballazhet e barnave dhe materialeve të mjekimit kanë mbetje të këtyre kimikateve, ndaj i cilësojmë si të nevojshme dhe të pandashme nga kodet e tjera dhe kodet 18 01 06 dhe 18 01 07.

Përsa i përket pretendimeve për kodin 18 01 08, autoriteti kontraktor i gjen sit ë pabazuar pretendimet e operatorit ekonomik, duke qënë se nuk jemi Spital Bashkiak, por Spital Rajonal dhe si i tillë përdorim dhe citostatikë, të cilat edhe pse mund të jenë në sasi të vogla, operatorët ekonomikë që do bëjë trajtirnin e tyre duhet të jetë e licensuar dhe e pajisur me kodin përkatës.

Të mos pranojë pikën nr.1 të ankesës të operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk për pikën 2.1.A.

Përsa i përket pikës nr.2.

Në lidhje me pikën 2.4.6 të kapacitetit teknik, autoriteti kontraktor vë në dijeni operatorin ekonomik “Medi Tel” shpk, se ka publikuar shtojcën nr.1, datë 11.09.2020 me ndryshimet e këtij kriteri.

Përsa i përket pikës nr.3

Në lidhje me pikën 2.4.10 të kapacitetit teknik, operatori ekonomik nuk ka argumentuar por vetëm ka cituar pikën 2.4.10 dhe për aq kohë sa nuk dimë pretendimet e operatorit ekonomik nuk mund të japim një përgjigje të argumentuar, gjithësesi autoriteti kontraktor vë në dijeni operatorin ekonomik “Medi Tel” shpk se ka publikuar shtojcën nr.1, datë 11.09.2020, me ndryshimet e këtij kriteri.

Përsa më sipër, personi përgjegjës për trajtimin e ankesës;

VENDOSI:

1- Të pranoj pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk.

2- Rekomandojmë titullarin e autoritetit kontraktor të vërë në dijeni operatorët ekonomikë për trajtimin e ankesës.

3- Kundër këtij vendimi, brenda afateve kohore të parashikuara në LPP, mund të bëhet ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.4. Në datën 21.09.2020 operatori ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk, ka depozituar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e kriterëve të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi me të njëjtat pretendime drejtuar autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon:

*2.1 Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër ka publikuar në adresën e ëëë.app.gov.al procedurën e prokurimit **KËRKESE PER PROPOZIM SHERBIME** me objekti i kontratës: “Evadim i mbetjeve spitalore për nevoja të DSR Dibër për vitin 2020”, Numri i referencës së procedurës: REF-70791-09-04-2020, fondi limit: 1,999,998 (Një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh dhe afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 18/09/2020, Ora: 10:00.*

*2.2 Operatori ekonomik “Medi-Tel” shpk do të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi publikuar në adresën e ëëë.app.gov.al, procedurën e prokurimit **KËRKESEË PËR PROPOZIM SHËRBIME** me objekti i kontratës: Evadim i mbetjeve spitalore për nevoja të DSR Dibër për vitin 2020”, Numri i referencës së procedurës: REF-70791-09-04-2020, fondi limit: 1,999,998 (Një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh, por nga shqyrtimi kriterëve të pjesëmarrjes në DST disa prej këtyre kriterëve janë të paligjshëm e në shpërpjestim me objektin e tenderit. Për këtë operatori ekonomik “Medi Tel” sh.p.k ka bërë ankesë pranë autoritetit kontraktor Drejtoria Spitalit Rajonal Dibër me Nr.47 Prot. datë 11.09.2020. Pas ankesës sonë autoriteti kontraktor ka pezulluar procedurën në faqen online ëëë.app.gov.al dhe më datë 18 .09.2020 e ka hequr nga pezullimi dhe ka publikuar shtojcën 2, datë 18.09.2020. Nga ndryshimet e publikuar në shtojcën 2 vërehet se nuk ka marrë parasysh ankesën tonë. Vlen të theksohet se deri më datë 21.09.2020, ora 09.20, operatori ekonomik “Medi Tel” sh.p.k nuk ka marrë asnjë përgjigje (në çfarëdo mënyre, postë, e-mail apo publikuar në ëëë.app.gov.al) nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër. Ankesa jonë konstaton si më poshtë:*

PIKA 1

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

A. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me vetë përcaktimet e dhëna në specifikimet teknike të vendosura nga AK në DST. Vetë AK në specifikimet teknike dhe në titullin e tenderit nuk përmend në asnjë pjesë se do të evadohen edhe kimikate, por gjatë gjithë përmbajtjes së kësaj procedure, AK i referohet gjithmonë mbetjeve spitalore.

Gjithashtu në shtojcën 1 të publikuar nga autoriteti kontraktor në DST datë 11.09.2020, tek Formualri i ofertës ekonomike” autoriteti kontraktor ka paraqitur grafikun si më poshtë:

Shtojca nr 1.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (objekti)

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
1	Evadim dhe trajtim i mbetjeve spitalore (Mbetje infektive te ngurta +Mbetje te mprehta+ Mbetje patologjike.)	Anatomo-patologjike 18 01 02 ~ 200 kg Te mprehtat 18 01 01 ~ 334 kg Infektive 18 01 03 ~ 4200 kg Te buta te pergj. 18 01 04 ~ 2000 kg	- - -		12 muaj

		Total 6.734kg			
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

Nga grafiku i kërkuar vërehet qartë se AK ka kërkuar ofertë ekonomike vetëm për Kodet 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03 dhe 18 01 04 dhe jo për kodet 18 01 06, dhe 18 01 07.

- Duke qënë se Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër në asnjë moment nuk përmend apo llogarit mbetje të këtyre kodeve (18 01 06 dhe 18 01 07) dhe se kriterin në fjalë e ka vendosur nga padija ose në rastin më të keq për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar. Vlen të theksohet se edhe nëse Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër do të dispononte apo prodhonte këto lloj mbetjesh që i përkasin kodeve 18 01 06 dhe 18 01 07 të cilat janë kimikate dhe si të tilla nuk duhen tenderuar në të njëjtën procedurë me atë të mbetjeve spitalore. Për këtë arsye kërkojmë që këto dy kode të hiqen nga ky kriter.

Përsa i përket kodit 18 01 08 (Medikamente citostatika dhe citotoksike) nga informacionet e marra, në dijeninë tonë Spitali Rajonal Dibër nuk i prodhon këto lloj mbetjesh dhe s'ii tillë këto lloj mbetjesh nuk duhet të kërkohen në këtë procedurë tenderimi. Por edhe nëse nga ana e Spitalit Rajonal Dibër pretendohet se gjenerohen këto lloj mbetjesh (citostatika dhe citotoksina) sasia që prodhohet nga Spitali Rajonal Dibër është shumë e vogël në krahasim me llojet e tjera të mbetjeve (18 01 01, 18 01 02 dhe 18 01 03) marrë shkas këtu edhe nga procedura e tenderimit nga Spitalet e tjerë Rajonal që operojnë në Republikën e Shqipërisë gjenerohen shumë më pak mbetje të këtij lloji, shoqëria jonë nuk e ka parë të arsyeshme pajisjen me leje përkatëse me kodin 18 01 08, pork a bërë një aktmarrveshje bashkëpunimi me një shoqëri të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve. Prandaj kërkojmë që ky kod (18 01 08) të hiqet ose në rast se Spitali Rajonal Dibër është prodhues i këtyre mbetjeve, ta modifikojë atë duke kërkuar Leje Mjedisore ose Licensë ku të ketë kodin 18 01 08 ose një aktmarrveshje me një operator të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve.

Ky kriter shkel:

nenin 46.1 të LPP që përcakton “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional; b) aftësia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare; q) kapacitetet ligjore.”.

Nenin 23.1 të LPP “Specifikimet teknike që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, pinëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshem e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

PIKA 2

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 24 muaj pas hapjes së ofertave (sa kohëzgjatja e marrveshjes kuadër).

Një kriter i tillë është në thelb diskriminues duke përjashtuar tërthorazi një operator ekonomik, në rastin konkret, duke kërkuar në mënyrë taksative afatin prej minimalisht 12 muajsh, në këtë mënyrë duke kategorizuar dhe përjashtuar çdo operator ekonomik që disponon një kontratë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertës dhe me të drejtë rinovimi, të lidhur me një landfill të licencuar. Ju kujtojmë se përkatësisht ne si operator ekonomik, në kontratën e lidhjes me landfillin “Integrated Energy BV SPV”, afati i saj është 1 vjeçar me të drejtë rinovimi. Ju bëjmë me dije se ky landfill nuk ofron kontrata me afat më shumë se 1 vit (12 muaj). Dhe duke qënë se ne si shoqëri ndodhemi në qarkun e Tiranës dhe Landfilli Integrated Energy BV SPV është landfilli i vetëm i licencuar në këtë qark jemi të detyruar të lidhim kontratë me këtë landfill. Një përcaktim prej një periudhe 24 mujore si një kriter kualifikimi bëhet pengesë duke penalizuar operatorin ekonomik mbështetur në një rrethanë që rëndësineë e vet duhet të përqëndrojë te fakti se operatorin ekonomik duhet të zotërojë një kontratë e cila në momentin e hapjes së ofertës të jetë aktive.

Për rrjedhojë ju drejtohem me këtë ankesë duke kërkuar nga ju ndërmarjen e masave për modifikimin e një kriteri përjashtues dhe diskriminues që në mënyrë decizive dhe jo të drejtë përjashton bazuar në këto cilësime. Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, të LPP dhe të të drejtave që i njeh operatorit ekonomik: kërkojmë modifikimin e këtij kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licencuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave.

PIKA3

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.4.10 Operatori ekonomik ofertues do të sjellë në ambjentet e autoritetit kontraktor në datën dhe orën e hapjes së tenderit nga një mostër të kontenitorëve si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje 60 kontenitorë (30 copë 3-7 L dhe 30 copë 30-70L) për mbulimin e nevojave AK

- Kontenierët e vegjël për mbetjet e mprehta, kontenitor plastik, minimalisht 2 përmasa me kapacitet nga 3 L deri në 7 litra, nga 1 mostër për secilën përmasë;

- Kontenierët e mëdhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhë me 1 përdorim, minimalisht 4 përmasa me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra (nga këto, të paktën njëra nga përmasat e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara) – nga 1 mostër për secilën përmasë.

Mostrat e dorëzuara, duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse mostra/t nuk është/janë në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e: “të paktën njëra nga përmasat e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara”, një kriter i tillë është në thelb diskriminues duke përjashtuar tërthorazi një operator ekonomik, në rastin konkret, duke kërkuar në mënyrë taksative që OE të paraqesë një mbajtëse metalike (karele), i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, pasi OE mund të disponojë/punoë (me) një formë karele të ndryshme nga kjo e kërkuar në DST. Duhet theksuar se karela në vetvete bën transportimin e kontenitorëve. Për më tepër mbajtësja metalike (karela) të cilës AK i referohet nuk bën mbyllje të sigurt të kapakut të kontenitorëve të mbetjeve (referuar të gjitha karelave të cilat bëjnë hapjen e kapakut me anë të pedanit), duke humbur kështu në tërësi evitimin e kontaktit të personelit me mbetjet e infektuara. AK është e vetëdijshme se kontenitorët janë të pajisura me qese, të cilat janë në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi, dhe duke marrë të mirëqënë faktin se punonjësit e DRS Dibër respektojnë me rigorozitet të gjitha masat parandaluese (maskë, doreza, dezinfektant, etj), si e tillë mundësia e kontaktit me pjesë të infektuara është e papërfillshme.

Ky kriter shkel:

nenin 46.1 të LPP që përcakton “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional; b) aftësia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare; q) kapacitetet ligjore.”.

Nenin 23.1 të LPP “Specifikimet teknike që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, pinëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshem e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Nisur nga kjo kërkojmë modifikimin e këtij kriteri si më poshtë:

2.4.10 Operatori ekonomik ofertues do të sjellë në ambjentet e autoritetit kontraktor në datën dhe orën e hapjes së tenderit nga një mostër të kontenitorëve si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje 60 kontenitorë (30 copë 3-7 L dhe 30 copë 30-70L) për mbulimin e nevojave AK

- Kontenierët e vegjël për mbetjet e mprehta, kontenitor plastik, minimalisht 2 përmasa me kapacitet nga 3 L deri në 7 litra, nga 1 mostër për secilën përmasë;*
- Kontenierët e mëdhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhë me 1 përdorim, minimalisht 4 përmasa me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra – nga 1 mostër për secilën përmasë.*
- Mbajtëse metalike/karelë me rrota.*

Mostrat e dorëzuara, duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse mostra/t nuk është/janë në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.843/1 prot, datë 15.10.2020, protokolluar me tonën me nr.1147/2 prot, datë 09.10.2020, me objekt “*Informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Medi Tel*” shpk, se: “*2.1. Për kapacitetin Iigjor/profesional:*

A. Operatori ekonomik duhet të disponoje Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me vetë përcaktimet e dhëna në specifikimet teknike të vendosura nga AK në DST. Vetë AK në specifikimet teknike dhe në titullin e tenderit nuk përmend në asnjë pjesë se do të evadohen edhe kimikate, por gjatë gjithë përmbajtjes së kësaj procedure, AK i referohet gjithmonë mbetjeve spitalore. Duke qënë se këto lloj mbetjesh që i përkasin kodeve 18 01 06 dhe 18 01 07 janë kimikate si të tilla nuk duhen tenderuar në të njëjtën procedurë me atë të mbetjeve spitalore. Për këtë arsye kërkojmë që këto dy kode të hiqen nga ky kriter.

Përsa i përket kodit 18 01 08 (Medikamente citostatika dhe citotoksike) nga informacionet e marra, në dijeninë tonë Spitali Rajonal Dibër nuk i prodhon këto lloj mbetjesh dhe s'ii tillë këto lloj mbetjesh nuk duhet të kërkohen në këtë procedurë tenderimi. Por edhe nëse nga ana e Spitalit Rajonal Dibër pretendohet se gjenerohen këto lloj mbetjesh (citostatika dhe citotoksina) sasia që prodhohet nga Spitali Rajonal Dibër është shumë e vogël në krahasim me llojet e tjera të mbetjeve (18 01 01, 18 01 02 dhe 18 01 03) marrë shkas këtu edhe nga procedura e tenderimit nga Spitalet e tjerë Rajonal që operojnë në Republikën e Shqipërisë gjenerohen shumë më pak mbetje të këtij lloji, shoqëria jonë nuk e ka parë të arsyeshme pajisjen me leje përkatëse me kodin 18 01 08, por a bërë një aktmarrveshje bashkëpunimi me një shoqëri të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve. Prandaj kërkojmë që ky kod (18 01 08) të hiqet ose në rast se Spitali Rajonal Dibër është prodhues i këtyre mbetjeve, ta modifikojë atë duke kërkuar Leje Mjedisore ose Licensë ku të ketë kodin 18 01 08 ose një aktmarrveshje me një operator të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”, pika 2.1.A të dokumentave të tenderit të modifikuara, rezulton se është kërkuar:

A. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

III.1.2. Nëpërmjet shkresës nr. 788/1 prot., datë 17.09.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk, si vijon: “Në lidhje me pikën 2.1.A të DST,
A. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

Përsa i përket pretendimeve të OE Medi-Tel për kodet 18 01 06 dhe 18 01 07 se janë kimikate dhe si të tilla duhet të hiqen nga kriteret, sqarojmë se të gjitha barnat janë të përbëra nga lëndë kimike gjatë prodhimit të tyre, dhe mbetjet që do trajtohen janë kryesisht amballazhet e barnave, dhe materiale mjekimi të cilat janë përdorur për të injektuar barna ose për të mjekuar pacientët me anë të barnave dhe detyrimisht amballazhet e barnave dhe materialeve të mjekimit kanë mbetje të këtyre kimikateve, ndaj i cilësojmë si të nevojshme dhe të pandashme nga kodet e tjera dhe kodet 18 01 06 dhe 18 01 07.

Përsa i përket pretendimeve për kodin 18 01 08, autoriteti kontraktor i gjen sit ë pabazuara pretendimet e operatorit ekonomik, duke qënë se nuk jemi Spital Bashkiak, por Spital Rajonal dhe si i tillë përdorim dhe citostatikë, të cilat edhe pse mund të jenë në sasi të vogla, operatorët ekonomikë që do bëjë trajtirnin e tyre duhet të jetë e licensuar dhe e pajisur me kodin përkatës. Të mos pranojë pikën nr.1 të ankesës të operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk për pikën 2.1.A.”.

III.1.3. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike”, të dokumenteve e modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

Shtojca nr 1.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (objekti)

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

3. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
4. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
1	Evadim dhe trajtim i mbetjeve spitalore (Mbetje infektive te ngurta +Mbetje te mprehta+ Mbetje patologjike.)	Anatomo-patologjike - 18 01 02 ~ 200 kg Te mprehtat - 18 01 01 ~ 334 kg Infektive - 18 01 03 ~ 4200 kg Te buta te pergj. 18 01 04 ~ 2000 kg <hr/> Total 6.734kg			12 muaj
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

III.1.4. Në shtojcën 8 “*Specifikimet Teknike*”, të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

Shtojca 8

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe anatomike duhet të asgjeshen në një impiant për incenerim i cili është i liçencuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi sipas përcaktimeve të mëposhtme në lidhje me to :

1. Në mbështetje të ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Ligjit Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”; Udhëzuesin kombëtar të Administrimit të Sigurtë të mbetjeve Spitalore, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 798, date 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e Mbetjeve Spitalore dhe ligjin nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
 - o Mbetje me Kodin: **18 01 01, 18 01 03 do** të asgjeshen sipas VKM-së **Nr.798, date 29.09.2010** “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, shtojca 3) Metodrat për trajtim dhe asgjësim pika 2) Me autoklavim, shtojca 5) Standartet teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore, Kjo metodë e mbështetur në udhëzimin Kombëtar “Për Udhëzuesin Kombëtar”Administrimini i Sigurtë i

Mbetjeve Spitalore”, Seksioni 7.1 ,Tabela 1.

- *Mbetjet me kodin 18 01 02 do të asgjesohen sipasVKM-së Nr.798, date 29.09.2010”Për administrimin e mbetjeve” Shtojca 3) Metodrat për trajtim dhe asgjesim, pika 1) Incenerim “ shtojca 5) Standartet teknike për incenerim dhe autoklavim e mbetjeve Spitalore. Kjo metodë e mbeshtetur në udhëzimin kombëtar “Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bëra në udhëzuesin kombëtar “Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore” seksioni 7.1, tabela 1.*
- 2. *Tërheqia e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave dhe kërkeses të Autoritetit Kontraktor.Mbetjet duhen të merren nga kontraktuesi pranë Autoritetit Kontraktor me mjet të posaçëm të sipërmarrësit dhe me ambalazhim përkatës në përputhje me standartet për mbetjet e rrezikshme spitalore duke respektuar standartin sipas VKM-së Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e Mbetjeve Spitalore” dhe udhëzuesin kombëtar “Administrim i sigurtë i Mbetjeve të Spitalore”.*
- 3. *Asgjesimi duhet të realizohet në zbatim të vendimit të këshillit të ministrave VKM-së Nr.798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve Spitalore”, si dhe udhëzuesi kombëtar “Administrim i sigurtë i Mbetjeve të Spitalore”.*
- 4. *Mbetjet do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dyja palëve nga një peshore, e cila duhet të disponohet nga Operatori Ekonomik.*
- 5. *Qeskat dhe kontenierët duhet të furnizohen nga operatori ekonomik. Qeskat duhet të jenë me një përdorim. Kontenierët duhet të jenë plastik, dhe te ofrohen minimalisht 2 permasa per kontenieret e vegjel per mbetjet e mprehta, me kapacitet nga 3 L ne 7 L (per te mprehtat), dhe minimalisht 4 permasa per kontenieret e medhenj per mbetjet infektive dhe ato te pergjithshme nga 30 L deri ne 70 L (nga keto, te pakten njera nga permasat duhet te jete me pedale dhe me rrota qe te kete opsionin e levizshmerise me karrele). Të gjithë kontenierët që përdoren nga spitali duhet të merren nga OE dhe të bëhet dezinfektimi i tyre prej saj. Ngjyrat dhe markimet e kontenitoreve duhet të jetë sipas përcaktimeve të bëra në VKM-në Nr.798, dt.29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, si dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore.*
- 6. *Operatori duhet te siguroje ambalazhin perkates sipas specifikimeve te caktuara ne **Udhëzuesin Kombëtar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore** . Furnizimi me ambalazh (kontenitore plastik me kapak dhe qese te verdhe me logon) furnizimi do te behet sipas kërkesave të AK.*
- 7. *Operatori Ekonomik duhet të pajisi A.K. me sinjalistikë dhe tabela sinjalizuese të cilat tregojnë prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambjentin/ambjentet përkatëse të Autoritetit kontraktor, në bazë të VKM-së Nr. 798, datë 29.09.2010 dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”.*
- 8. *Operatori ekonomik dhe Përfaqësuesit e Spitalit për çdo dorëzim mbetjesh spitalore tek operatori për asgjesim do të mbajnë”Dokumentin e dorëzimit të mbetjeve të Rrezikshme” sipas VKM-së Nr.371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, saktësia e plotësimit të dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme, do të sigurohet nëpërmjet dokumentit të peshimit të gjeneruar nga peshorja e lektronike e automjeteve.*
- 9. *Mbetjet e vendosura në ambalazh do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të të dy palëve, hartohet proces - verbali për sasinë e peshuar në tre kopje dhe nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktor. Dy kopje mbeten në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor*

dhe një kopie e merr kontraktuesi. Tek formulari i transferimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore të shenohen dhe kodet perkatëse për çdo lloj mbetje:

- Anatomiket KODI 18 01 02
- Te mprehtat KODI 18 01 01
- Te butat, plastiket KODI 18 01 03.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”

“[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”.

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 30, pika 1 dhe 2 është përcaktuar:

1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të

vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.6. Në VKM Nr.914, datë 29.12.2014, neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon ”

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose 12

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në kërkesën për kualifikim të dhënë në Shtojcën 7, pika 2.1.A ka përcaktuar se: “A. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe licencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.”, ndërkohë që referuar Shtojcës 1 “Formulari i ofertës ekonomike dhe Shtojcës 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të modifikuara të tenderit konstatohet se autoriteti kontraktor kërkon që të bëjë evadimin e mbetjeve spitalore, si në vijim: “Mbetje Anato-mo-patologjike me kodin 18 01 02; Mbetje të mprehta me kodin 18 01 01; Mbetje infektive me kodin 18 01 03 dhe Mbetje të buta të përgjithshme me kodin 18 01 04.”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar konfuzionin. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: “2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.9. Në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kërkesa për kualifikim e dhënë nga autoriteti kontraktor, për disponimin nga ana e ofertuesve të Lejes Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe të liçencë profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me përmasat dhe natyrën e kontratës që prokurohet, në lidhje me kodet 18 01 06, 18 01 07 dhe 18 01 08, pasi referuar Shtojcës 1 “Formulari i ofertës ekonomike” dhe Shtojcës 8 “Specifikimet teknike” autoriteti kontraktor nuk ka në objektin e prokurimit evodimin e mbetjeve spitalore me kodet e sipërpërmendura dhe të pretenduara nga ana e ankimuesit.

Përsa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk, se: “2.1. Për kapacitetin Iigjor/profesional:

A. Operatori ekonomik duhet të disponoje Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e agjesimit të jetë me incenerim.

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me vetë përcaktimet e dhëna në specifikimet teknike të vendosura nga AK në DST. Vetë AK në specifikimet teknike dhe në titullin e tenderit nuk përmend në asnjë pjesë se do të evadohen edhe kimikate, por gjatë gjithë përmbajtjes së kësaj procedure, AK i referohet gjithmonë mbetjeve spitalore. Duke qënë se këto lloj mbetjesh që i përkasin kodeve 18 01 06 dhe 18 01 07 janë kimikate si të tilla nuk duhen tenderuar në të njëjtën procedurë me atë të mbetjeve spitalore. Për këtë arsye kërkojmë që këto dy kode të hiqen nga ky kriter.

Përsa i përket kodit 18 01 08 (Medikamente citostatika dhe citotoksike) nga informacionet e marra, në dijeninë tonë Spitali Rajonal Dibër nuk i prodhon këto lloj mbetjesh dhe si i tillë këto lloj mbetjesh nuk duhet të kërkohen në këtë procedurë tenderimi. Por edhe nëse nga ana e Spitalit Rajonal Dibër pretendohet se gjenerohen këto lloj mbetjesh (citostatika dhe citotoksina) sasia që prodhohet nga Spitali Rajonal Dibër është shumë e vogël në krahasim me llojet e tjera të mbetjeve (18 01 01, 18 01 02 dhe 18 01 03) marrë shkas këtu edhe nga procedura e tenderimit nga Spitalet e tjerë Rajonal që operojnë në Republikën e Shqipërisë gjenerohen shumë më pak mbetje të këtij lloji, shoqëria jonë nuk e ka parë të arsyeshme pajisjen me leje përkatëse me kodin 18 01 08, por a bërë një aktmarrveshje bashkëpunimi me një shoqëri të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve. Prandaj kërkojmë që ky kod (18 01 08) të hiqet ose në rast se Spitali Rajonal Dibër është prodhues i këtyre mbetjeve, ta modifikojë atë duke kërkuar Leje Mjedisore ose Licensë ku të ketë kodin 18 01 08 ose një aktmarrveshje me një operator të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.5 të dokumentave të tenderit të modifikuara, rezulton se është kërkuar:

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 12 muaj pas hapjes së ofertave (sa kohezjatja e marrveshjes kuader).

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka nuk pranuar pretendimin e mësipërm duke arsyetuar si vijon: *”Përsa i përket pikës nr.2. Në lidhje me pikën 2.4.6 të kapacitetit teknik, autoriteti kontraktor vë në dijeni operatorin ekonomik “Medi Tel” shpk, se ka publikuar shtojcën nr.1, datë 11.09.2020 me ndryshimet e këtij kriteri.”.*

III.2.3. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 12 muaj pas hapjes së ofertave. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni vlereson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Referuar kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon se kërkesa që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave, është një kërkesë e drejtë, e cila i shërben autoritetit kontraktor, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë kanë aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme për zbatimin me korrektësi të kontratës. Por, KPP gjykon se, kërkesa që kjo kontratë midis operatorit ekonomik dhe një landfili për depozitimin e mbetjeve të jetë domosdoshmërisht e vlefshme për 12 muaj pas hapjes së ofertave, është një kërkesë e ekzagjeruar, diskriminuese dhe jo në funksion të qëllimit për të cilin është vendosur ky kriter.

Komisioni vlerëson se kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik duke kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke hequr kërkesën që kontrata me landfillin të jetë e vlefshme për 12 muaj që në momentin e hapjes së ofertave, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të

kontratës duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

III.2.4. Sa më sipër, KPP gjykon se, është detyrim i operatorëve ekonomikë që në rast të shpalljes fitues ti përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtin cilësi të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Medi Tel*” shpk, se: “*2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:*

A. Operatori ekonomik duhet të disponoje Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 06, 18 01 07, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me vetë përcaktimet e dhëna në specifikimet teknike të vendosura nga AK në DST. Vetë AK në specifikimet teknike dhe në titullin e tenderit nuk përmend në asnjë pjesë se do të evadohen edhe kimikate, por gjatë gjithë përmbajtjes së kësaj procedure, AK i referohet gjithmonë mbetjeve spitalore. Duke qënë se këto lloj mbetjesh që i përkasin kodeve 18 01 06 dhe 18 01 07 janë kimikate si të tilla nuk duhen tenderuar në të njëjtën procedurë me atë të mbetjeve spitalore. Për këtë arsye kërkojmë që këto dy kode të hiqen nga ky kriter.

Përsa i përket kodit 18 01 08 (Medikamente citostatika dhe citotoksike) nga informacionet e marra, në dijeninë tonë Spitali Rajonal Dibër nuk i prodhon këto lloj mbetjesh dhe si i tillë këto lloj mbetjesh nuk duhet të kërkohen në këtë procedurë tenderimi. Por edhe nëse nga ana e Spitalit Rajonal Dibër pretendohet se gjenerohen këto lloj mbetjesh (citostatika dhe citotoksina) sasia që prodhohet nga Spitali Rajonal Dibër është shumë e vogël në krahasim me llojet e tjera të mbetjeve (18 01 01, 18 01 02 dhe 18 01 03) marrë shkas këtu edhe nga procedura e tenderimit nga Spitalet e tjerë Rajonal që operojnë në Republikën e Shqipërisë gjenerohen shumë më pak mbetje të këtij lloji, shoqëria jonë nuk e ka parë të arsyeshme pajisjen me leje përkatëse me kodin 18 01 08, por a bërë një aktmarrvëshje bashkëpunimi me një shoqëri të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve. Prandaj kërkojmë që ky kod (18 01 08) të hiqet ose në rast se Spitali Rajonal Dibër është prodhues i këtyre mbetjeve, ta modifikojë atë duke kërkuar Leje Mjedisore ose Licensë ku të ketë kodin 18 01

08 ose një aktmarrvëshje me një operator të licensuar për trajtimin e këtyre mbetjeve.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në datë 08.10.2020, në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.10 të dokumentave të tenderit, rezulton se është kërkuar:

2.4.10. Operatori ekonomik ofertues do të sjelle në ambientet e Autoritetit Kontraktor në datën dhe oren e hapjes së tenderit nga një moster të kontenitoreve si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje 60 kontenitore (30 cope 3-7 L dhe 30 cope 30-70L) për mbulimin e nevojave AK

- Kontenieret e vegjel për mbetjet e mprehta, kontenitor plastik, minimalisht 2 permase me kapacitet nga 3 L deri në 7 litra, nga 1 moster për secilën permase;

- Kontenieret e medhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhe me 1 përdorim, minimalisht 4 permase me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra (nga këto, të pakten njëra nga permasat e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara)

– nga 1 moster për secilën permase.

Mostrat e dorëzuara, duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit. Nëse ka mungesë mostrash për artikuj të veçantë ose nëse mostra/t nuk është/jane në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s’kualifikohet..

III.3.2. Në datë 11.09.2020, autoriteti kontraktor modifikon dokumentat e tenderit, duke publikuar shtojcën me përcaktimet si më poshtë:

3. Në pikën 2.4.10 të shtojcës nr. 7.2, Kriteret e veçantë të Kualifikimit, behen ndryshimet si më poshtë:

Ishte:

2.4.10 Operatori ekonomik ofertues do të sjelle në ambientet e Autoritetit Kontraktor në datën dhe oren e hapjes së tenderit nga një moster të kontenitoreve si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje 60 kontenitore (30 cope 3-7 L dhe 30 cope 30-70L) për mbulimin e nevojave AK

- Kontenieret e vegjel për mbetjet e mprehta, kontenitor plastik, minimalisht 2 permase me kapacitet nga 3 L deri në 7 litra, nga 1 moster për secilën permase;

- Kontenieret e medhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhe me 1 përdorim, minimalisht 4 permase me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra (nga këto, të pakten njëra nga permasat e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara)

– nga 1 moster për secilën permase.

Mostrat e dorëzuara, duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçante ose nëse mostra/t nuk është/jane në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s'kualifikohet.

Behet:

2.4.10 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje 60 kontenitore (30 cope 3-7 L dhe 30 cope 30-70L) për mbulimin e nevojave, vertuar kjo me fature tatimore blerje.

4. Në shtojcën nr 7.2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pas pikës 10 shtohet pika 2.4.11, si më poshtë:

2.4.11 AK Operatori ekonomik ofertues do të sjellë në ambjentet e Autoritetit Kontraktor në datën dhe orën e hapjes së tenderit nga një mostër të kontenitoreve si më poshtë:

- Kontenieret e vegjel për mbetjet e mprehta, kontenitor plastik, minimalisht 2 permase me kapacitet nga 3 L deri në 7 litra, nga 1 mostër për secilën permase;

- Kontenieret e mëdhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhe me 1 përdorim, minimalisht 4 permase me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra (nga këto, të paktën njëra nga permaset e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara)

– nga 1 mostër për secilën permase.

Mostrat e dorëzuara, duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçante ose nëse mostra/t nuk është/jane në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s'kualifikohet.

III.3.3. Nëpërmjet shkresës nr. 788/1 prot., datë 17.09.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk, si vijon: “Përsa i përket pikës nr.3: Në lidhje me pikën 2.4.10 të kapacitetit teknik, operatori ekonomik nuk ka argumentuar por vetëm ka cituar pikën 2.4.10 dhe për atë kohë sa nuk dimë pretendimet e operatorit ekonomik nuk mund të japim një përgjigje të argumentuar, gjithësesi autoriteti kontraktor vë në dijeni operatorin ekonomik “Medi Tel” shpk se ka publikuar shtojcën nr.1, datë 11.09.2020, me ndryshimet e këtij kriteri.”.

III.3.4. Në rastin konkret K.P.P konstaton se edhe pas modifikimit të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, pretendimi i ankimuesit lidhur me modifikimin e kriterit kualifikues të Pikës 2.4.10, të Shtojcës 7, të dokumentave të tenderit lidhur me: “Paraqitjen e mostrës së: Kontenierët e mëdhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhë me 1 përdorim, minimalisht 4 permase me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra (nga këto, të paktën njëra nga permaset e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara)”, do të konsiderohet e refuzuar, ndonëse nga ana e entit prokurues është modifikuar ky kriter, duke u hequr përcaktimet e sipërpërmendura, por nga ana tjetër këto përcaktime janë rikërkuar në dokumentat e tenderit duke u shtuar pika 2.4.11 e dokumentave të tenderit sipas Shtojcës 1, të publikuar më datë 11.09.2020.

III.3.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.3.6. Në VKM Nr.914, datë 29.12.2014, neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon ”

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose 12

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.3.7. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në Kreun I, “Dispozita të përgjithshme” pika 2/b, d, parashikohet shprehimisht:

2. Përkufizime të termave

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

b) “Prodhues i mbetjes” është personi fizik dhe juridik, i cili zotëron ose administron një institucion shëndetësor, që krijon mbetje spitalore, duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar vetëm në: spitale, poliklinika, qendrat shëndetësore, kabinete mjekësore, qendra mjekësore, kabinete dentare, klinika dentare, laboratorë dentarë, qendra diagnostike, depo farmaceutike, farmacitë, qendra kozmetike, qendra të tatuazhit, qendra të rehabilitimit nga droga, laboratorët e shëndetit publik, institucionet kërkimore-shkencore, banka e gjakut, morget, shërbimet funerale, klinikat veterinare, shërbimet ambulatorë të infermierisë që vizitojnë pacientë në banesa.

d) “Transport” është veprimtaria që lidhet me transportin e mbetjeve spitalore, duke përfshirë ngarkimin, transportimin e shkarkimin, sikurse dhe përgatitja, shërbimi e mirëmbajtja e pajisjeve të përdorura për transportin e mbetjeve spitalore.

Në Kreun II “Detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore”, pika 5/, a b dhe c parashikohet shprehimisht: 5. Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për:

- a) grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë institucionit shëndetësor;
- b) ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme;
- c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme, të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre;

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në kërkesën për kualifikim të sipërcituar ka përcaktuar se: *“Paraqitjen e mostrës së: Kontenierët e mëdhenj për mbetjet me potencial infektues dhe ato të përgjithshmet, kontenitor plastik shoqëruar me qese të verdhë me 1 përdorim, minimalisht 4 përmasa me kapacitet nga 30 L deri në 70 litra (nga këto, të paktën njëra nga përmasat e koshave duhet të ketë mbajtëse koshi metalike me rrota dhe pedal, i cili duhet të jetë i lidhur me kapakun e koshit për të bërë të mundur hapjen dhe mbylljen e tij, kjo për të evituar kontaktin e personelit me mbetjet apo pjesët e koshit të infektuara)”*, ndërkohë që referuar informacionit të dërguar më shkresën nr.843, datë 15.10.2020, si dhe shkresës nr.788/1 prot, datë 17.09.2020, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoriteti kontraktor nuk jepet asnjë argumentim ligjor lidhur me vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

III.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar konfuzionin. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.9. Në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kërkesa për kualifikim e dhënë nga autoriteti kontraktor, për kalrelëve specifik për kontenierë të mëdhenj të cilët të jenë të lidhur me kapakun është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me përmasat, pasi kjo kërkesë jo vetëm nuk është e argumentuar nga ana e autoritetit kontraktor se në cilën bazë ligjore është mbështetur, por njëkohësisht referuar bazës ligjore të sipërcituar nuk parashikohet ndonjë kusht i

tillë lidhur me karrelin që do të bëjë transporti e kontenierëve të mëdhenj të mbetjeve spitalore.

Përsa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medi Tel” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-70791-09-04-2020, me objekt: “Evadim mbetje spitalore per nevoja te DSR Diber per vitin 2020”, me fond limit 1.999.998 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2020, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Medi Tel” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1147 Protokoli, Datë 21.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri